

## TERMAT E REFERENCES

|                                   |                                                                                                                                                                                                           |
|-----------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Lloji i vlerësimit</b>         | Ekspert për ofrimin e shërbimeve të konsulencës për analizimin e gjendjes aktuale për strehim familjar si dhe mbështetjen e grupit punues në hartimin e Planit Nacional të Veprimit për Strehim Familjar. |
| <b>Vendi</b>                      | Kosovë                                                                                                                                                                                                    |
| <b>Lloji i konsulencës</b>        | Ekspert individual                                                                                                                                                                                        |
| <b>Kohëzgjatja</b>                | Qershor- Gusht (orientimisht 10 ditë angazhim)                                                                                                                                                            |
| <b>Data e pritshme e fillimit</b> | Qershor 2025                                                                                                                                                                                              |
| <b>I raporton</b>                 | SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë                                                                                                                                                                           |

### 1. Hyrje

Këto terma të referencës shërbejnë si kërkesë për propozime nga ekspertët individual që janë të interesuar për ofrimin e shërbimeve të konsulencës për analizimin e gjendjes aktuale të strehimit familjar në Kosovë, si dhe lehtësimin dhe mbështetjen e grupit punues në hartimin e Planit Nacional të Veprimit për Strehim Familjar.

### SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve Internacional është organizata ombrellë e federatës botërore e 118 shoqatave kombëtare të SOS Fshatrave të Fëmijëve, që veprojnë me programet e tyre në shumë vende të botës. Ne punojmë bashkërisht me një vizion të vetëm: çdo fëmijë i përket një familje dhe rritet me dashuri, respekt dhe i sigurt. Ne ofrojmë përkujdesje afatgjatë familjare, në mënyrë unike, për fëmijët dhe të rinjtë që e kanë humbur kujdesin prindëror, me familjet dhe komunitetet e cënueshme për t'u ndihmuar që të fuqizohen dhe ta parandalojnë braktisjen e fëmijëve.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është organizatë joqeveritare për zhvillim social, e cila është aktive në fushën e të drejtave të fëmijëve duke i mbështetur nevojat dhe shqetësimet e tyre që nga viti 1999. Ne ndërtojmë familje për fëmijë pa përkujdesje prindërore, ne u ndihmojmë atyre që ta formësojnë të ardhmen e tyre dhe marrim pjesë në zhvillimin e komuniteteve të tyre.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë punon në partneritet me institucionet përgjegjëse, organet shtetërore, akterët kryesorë, organizatat kryesore dhe ofruesit e shërbimeve në fushën e mbrojtjes sociale të fëmijëve në nevojë, dhe u krijon mundësi të rinjve që të përfshihen me kontributin dhe ndikimin e tyre në formësimin dhe hartimin e politikave dhe në zhvillimin e shërbimeve dhe programeve.

## 1.1 Konteksti i programit

Në kuadër të planit strategjik dhe aktiviteteve avokuese për të mbështetur proceset e nivelit nacional në zhvillimin dhe fuqizimin e strehimit familjar po kërkojmë një ekspert tematik individual për ofrimin e shërbimeve të konsulencës për analizimin e gjendjes aktuale të strehimit familjar në Kosovë, si dhe lehtësimin dhe mbështetjen e grupit punues në hartimin e Planit Nacional të Veprimit për Strehim Familjar.

## 1.2 Kohëzgjatja e angazhimit

Koha e synuar e angazhimit është Qershor- Gusht 2025, ku vlerësohen orientimisht 10 ditë angazhimi në raport me rezultatet e pritshme.

## 2. Qëllimi i shërbimit

### 2.1. Qëllimi

Qëllimi i këtij angazhimi është ofrimi i shërbimeve të konsulencës për analizimin e gjendjes aktuale të strehimit familjar në Kosovë, si dhe lehtësimin dhe mbështetjen e grupit punues në hartimin e Planit Nacional të Veprimit për Strehim Familjar.

### 2.2. Rezultatet e pritshme

- Raport analitik mbi gjendjen aktuale të strehimit familjar në Kosovë, duke përfshirë rishikimin e kornizës ligjore, politikave ekzistuese, kapaciteteve institucionale dhe praktikave aktuale të strehimit familjar në nivel komunal.
- Realizimin e takimeve me grupin punues për të filluar përgatitjen e Planit Nacional të Veprimit për Strehim Familjar
- Lehtësimi i punëtorëve të grupit punues përfshirë organizimin, dokumentimin dhe përpunimin e komenteve nga aktetë relevante (institucione shtetërore, OShC, partnerët, etj.).
- Draftimi i Planit Nacional të Veprimit për Strehim Familjar, i ndërtuar mbi analiza të bazuara në evidencë dhe konsultime gjithëpërfshirëse.
- Dorëzimi i planit final të rishikuar, i harmonizuar me komentet nga grupi punues dhe palët kyçe, duke përfshirë objektiva strategjike, aktivitete të propozuara, vlerësimi i kostos së aktiviteteve të planifikuara, identifikimi i burimeve të financimit për aktivitetet e planifikuara, afatet kohore dhe indikatorë të matshëm të suksesit.

Plani i punës së bashku me metodologjinë e propozuar të cilat i ofron eksperti duhet të përshkruajnë në detaje planin e punës dhe metodologjinë (metodat dhe mjetet e punës) duke

përfshirë edhe objektivat kryesore, hapat dhe procedurat se si do të realizohet angazhimi, përpilimi i të dhënave, afati kohor, etj.

### **3. Shkathtësitë e kërkuara (përvoja dhe kualifikimet) nga eksperti**

- Kompetencë/përvojë të dëshmuar (të dhënat e përvojës paraprahe) në angazhime të ngjashme;
- Nivel universitar shkollimi në shkenca sociale, juridik, menaxhim projektesh ose ndonjë fushë te ngjashme.
- Të ketë përvojë së paku tri vjet përvojë në fushën e hartimit të akteve ligjore juridike ose punës në fushën e mbrojtjes sociale, punës ose dialogut social;
- Të ketë përvojë të dëshmuar në përpilim dhe hartim të dokumenteve në fushën përkatëse;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme analitike dhe konceptuale;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme në shkrim dhe komunikim;
- Duhet të ketë njohuri të mira për sistemin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve;
- Të ketë njohuri të mira për sistemin e shërbimeve sociale dhe familjare;
- Të ketë përvojë dhe punë të dëshmuar me institucione nga sektori shoqëror dhe organizata që ofrojnë shërbime sociale;
- Duhet të ketë përvojë të dëshmuar të bashkëpunimit efektiv me institucionet publike në nivelin qendror dhe lokal, ofruesit e shërbimeve publike dhe OJQ-të;
- Duhet të ketë shkathtësi të mira personale dhe ndër-personale për punë në ekip;
- Duhet të garantojë dorëzimin me kohë të rezultateve dhe detyrave të pritshme;
- Duhet të jetë i njoftuar me standardet etike lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët dhe do t'i kërkohej që të nënshkruajë dhe t'i përmbahet Politikave për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Njohuri dhe përvoja të punës/ bashkëpunimit të mëhershëm me SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është përparësi.

### **4. Produktet që duhet të dorëzohen në fund të angazhimit:**

- Dorëzimi i draftit përfundimtar të Planit Nacional të Veprimit për Strehim Familjar përfshirë raportin analitik mbi gjendjen aktuale të strehimit familjar në Kosovë.

## 5. Aneksi – Politikat e SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë e ka dokumentin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve dhe kodin e sjelljes, të cilat eksperti pritët t'i përmbahet dhe nga ta do të kërkohet ta nënshkruajnë deklaratën e përkushtimit ndaj Politikave të SOS Fshatrave të Fëmijëve të cilat përfshijnë: Politikën për mbrojtjen e fëmijëve, Rregullorja për Parandalimin dhe mbrojtjen kundër ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, Kodin e mirësjelljes, Deklarata për ruajtjen e të dhënave si dhe Rregullore kundër korrupsionit. Kjo do të bëhet me rastin e nënshkrimit të kontratës, ku konsulenti do të udhëzohet lidhur me proceset e brendshme të mbrojtjes së fëmijëve.

## 6. Udhëzime për ofertuesit (procesi i dorëzimit të ofertave)

I ftojme ofertuesit që t'i dorëzojnë propozimet e tyre për mbështetjen e hartimit të Planit Nacional të Veprimit për Strehim Familjar

Në formatin PDF dhe t'i dërgojnë në mënyrë elektronike në [procurement1@soskosova.org](mailto:procurement1@soskosova.org)

Oferta është e hapur për të gjithë ekspertët e pavarur që mund t'i ofrojnë shërbimet e kërkuara. Propozimi dhe të gjitha dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe. Oferta financiare duhet të shprehet në Euro.

### Dokumentet që duhet dorëzuar:

- CV e ekspertit (përfshirë tri referenca pune- kontaktet)
- Propozimi teknik dhe metodologjia për kryerjen e shërbimit të kërkuar
- Kopje e letër-njoftimit
- Propozimi financiar- çmimi duhet të konsiderohet pagesë BRUTO

(Oferta duhet të jetë e vlefshme për dy javë).

Ofertuesi i përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë prova:

- vërtetim që nuk është nën hetime

## 7. Kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet e pagesës

- Pagesa do të realizohet në një shumë fikse, totale për të gjithë angazhimin.
- Pagesa do të bëhet vetëm pasi SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë ta pranojë punën e realizuar sipas produkteve të përshkruara më lartë. Pagesa do të bëhet nëpërmjet transferit bankar në llogarinë bankare të ekspertit individual duke ndalur tatimin në të ardhura personale dhe



kontributin pensional, sipas ligjit në fuqi dhe jo më vonë se 30 ditë pas pranimit të punës së realizuar;

- Pagesa për ekspertin do të bëhet me rastin e dorëzimit të versionit final të Planit Nacional të Veprimit për Strehim Familjar;

#### Kriteret e përzgjedhjes:

| Kriteret                                                                                                                                                                                      | Maksimumi i pikëve |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Përvoja e ekspertit në procese të këtilla angazhimi (të bashkëngjitet CV ). Vlerësimi bëhet në bazë të kualifikimeve dhe përvojës.</li></ul>          | 30                 |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Metoda (metodologjia) e propozuar për realizimin e shërbimit është e përshtatshme, ndërsa plani i punës është real dhe e përmbush qëllimin.</li></ul> | 35                 |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Çmimi i ofertës financiare</li></ul>                                                                                                                  | 35                 |
| <b>Totali</b>                                                                                                                                                                                 | <b>100</b>         |

#### Afati për dorëzim:

Aplikacioni duhet të dërgohet më së voni më: 05.06.2025 deri në mesnatë. Aplikacionet që dërgohen pas këtij afati nuk do të merren parasysh.